

Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil merr pjesë në Konferencën për të Drejtën e Informimit

Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Lefterije Lleshi (Luzi), mori pjesë në Konferencën e VII Kombëtare për të Drejtën e Informimit, organizuar nën kujdesin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, në bashkëpunim me ministren e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni.



Konferenca e VII Kombëtare për të Drejtën e Informimit u mbajt në Tiranë, në përmblyllje të “Javës së Integrimit 2025” dhe shërbeu si një platformë kombëtare dialogu, mbi sfidat e institucioneve publike, për të rritur transparencën dhe llogaridhënien, në kuadër të procesit të integrimit evropian.